EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5725
E enjte, 14 mars 2019
çmimi 0.40 €

Rreth 300 persona kërkohen nga Policia e Kosovës

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DREJTORI I PËRGJITHSHËM PËR ÇËSHTJE POLITIKE NË MINISTRINË E JASHTME TË MBRETËRISË SË BASHKUAR, RICHARD MOORE, KA VIZITUAR REPUBLIKËN E KOSOVËS FAQE 4-5

BRITANIA KËRKON PEZULLIMIN E TAKSËS

Pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Gjermanisë, edhe Britania ka kërkuar nga Kosova pezullimin e taksës ndaj produkteve serbe dhe boshnjake. Këtë kërkesë e ka parashtruar të mërkurën në Prishtinë drejtori i Përgjithshëm për Çështje Politike në Ministrinë e Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Richard Moore, gjatë takimeve që ka pasur me kryeministrin Ramush Haradinaj dhe me bashkëkryesuesit e ekipit negociator për bisedime me Serbinë, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti. Moore ka bërë me dije se Britania e mbështet dhe e inkurajon Kosovën për vazhdimin e dialogut dhe për arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë e cila ka për qëllim njohjen e ndërsjellë

POZITA DHE OPOZITA I BËJNË THIRRJE PRESIDENTIT T'I EMËROJË ANËTARËT E KQZ-së

Grupet parlamentare të pozitës dhe ato të opozitës i kanë bërë thirrje presidentit Hashim Thaçi që sa më shpejt t'i emërojë anëtarët e KQZ-së. Në seancën e thirrur nga opozita për debat parlamentar në lidhje me bllokimin e KQZ-së nga presidenti, përfaqësuesit e LDK-së dhe të LV-së kanë theksuar se këtyre partive u takojnë nga dy anëtarë të KQZ-së, në të kundërtën do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Por, përfaqësuesit e pozitës nuk janë pajtuar që LDK-së dhe LV-së t'i takojnë nga dy anëtarë në KQZ

Veseli merr përkrahje nga Japonia për proceset integruese për Kosovën

FAQE 2

AKTUALE

SERBIA PO E PENGON FUNKSIONIMIN E RYCO-s F. 6

KOSOVA ANËTARËSOHET NË ORGANIZATËN NDËRKOMBËTARE PËR RUAJTJEN E NATYRËS F. 6

HARADINAJ: DIALOGU KA DEGRADUAR F. 7

EKONOMI

KOSOVA NDALON OPERIMIN E AEROPLANËVE 'BOEING' F. 9

BIZNESET PO HASIN NË PROBLEME ME TRANSAKSIONET BANKARE F. 9

KULTURË

ORA E HISTORISË F. 13

Prof. dr. Agim VINCA

SPORT

TOPALLI: BALLKANI PA PROBLEM E SIGURON MBIJETESËN F. 12

UJI 'RUGOVE', SPONSOR I FBK-së F. 12

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

DASh identifikon disa shkelje të të drejtave të njeriut në Kosovë

UASHINGTON, 13 MARS - Departamenti Amerikan i Shtetit publikoi të mërkurën raportin për të drejtat e njeriut në botë në vitin 2018, ku në pjesën për Kosovën nxjerr si problem kthimin e detyrueshëm të refugjatëve ose azilkërkuesve, korrupsionin endemik në qeveri, dhunën dhe kërcënimet e dhunshme kundër gazetarëve dhe sulmet kundër anëtarëve të pakicave etnike ose komuniteteve të tjera të margjinalizuara.

Raporti thekson rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova për në Turqi, ku ata, siç thuhet, janë kërkuar "nën akuza të paqarta". "OJQ-të dhe Institucioni i Avokatit të Popullit kanë thënë se qeveria ua ka mohuar të drejtën të ndaluarve për të kërkuar azil ose për ta apeluar vendimin për dëbim para gjykatës. OJQ-të dhe politikanët e opozitës kanë thënë se dëbimi i përshpejtuar ka qenë i motivuar politikisht", thekson raporti.

I njëjti kujton se "kryeministri i Kosovës ka shkarkuar ministrin e Brendshëm dhe drejtorin e Agjencisë së Inteligjencës të Kosovës si rezultat i incidentit".

Te pjesa për lirinë e shprehjes, raporti thekson se Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës e garantojnë lirinë e shprehjes dhe se qeveria në përgjithësi e ka respektuar këtë të drejtë. Por, thuhet tutje, raporte të besueshme kanë përsëritur se disa zyrtarë publikë, politikanë, biznesmenë dhe grupe radikale fetare kanë bërë përpjekje t'i frikësojnë përfaqësuesit e medieve.

Veseli merr përkrahje nga Japonia për proceset integruese për Kosovën

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, po qëndron për vizitë zyrtare në Japoni, ku ka marrë përkrahje për proceset integruese për Kosovën, si dhe i është konfirmuar se shumë shpejt do të hapet edhe Ambasada e Japonisë në Prishtinë



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në ditën e parë të vizitës së tij në Tokio, është pritur në takim nga Oshima Tadamori, kryetar i Parlamentit të Japonisë, ku temë kryesore e takimit ishte thellimi i bashkëpunimit bilateral ndërmjet dy vendeve, sidomos në fushën e ekonomisë.

Kryeparlamentari Veseli falënderoi homologun Tadamori për përkrahjen e vazhdueshme që ka dhënë Qeveria e Japonisë për Kosovën që nga përfundimi i luftës e deri më tani. Veseli bëri një ekspoze të zhvillimeve të fundit në Kosovë, me theks të veçantë për mundësitë që ofron ekonomia e Kosovës për projekte investive nga kompanitë japoneze, sidomos në fushën e teknologjisë së informacionit. "Vendi juaj, me modelin e zhvillimit që përfaqëson, është model frymëzues për të rinjtë tanë që duan t'i përkushtohen inovacionit dhe ndërrmarrësisë", ka thënë Veseli. Ai ka theksuar se Kosova si shtet i ri dhe demokraci e re ndihet mirë që një vend mik si Japonia është në mbështetje të synimeve të saj.

Kryetari i Parlamentit të Japonisë, Tadamori, nga ana e tij ka thënë se shteti japonez vazhdon të jetë i përkushtuar në thellimin e marrëdhënieve me Kosovën, në të gjitha fushat ku ekzistojnë mundësitë, sidomos në investimet ekonomike.

Duke u ndalur te vlerat e përbashkëta që kanë dy popujt tanë, Tadamori u shpreh se gjithmonë e impresionon figura e humanistes shqiptare Nënë Tereza. "Misioni i kësaj gruaje të madhe flet shumë për popullin tuaj", ka thënë Tadamori.

Ai përmendi suksesin kosovar në sportin e xhudos. "Jeni bërë të pakonkurrencë në xhudo. Pres të triumfoni edhe në Lojërat Olimpike Tokio 2020", ka thënë kreu i Parlamentit të Japonisë.

Gjatë ditës së mërkurë Veseli është pritur në takim edhe nga ministri i Punëve të Jashtme i Japonisë, Taro Kono, ku u diskutua për marrëdhëniet bilaterale në mes të dy vendeve.

Kryeparlamentari Veseli dhe kryediplomati japonez theksuan se 11-vjetori i këtyre marrëdhënieve i gjen të dy vendet me nivel bashkëpunimi në shumë fusha. Veseli ka thënë në takim se Kosova në këta 11 vjet të ekzistencës si shtet është dëshmuar si faktor i paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në rajon dhe vazhdon të punojë me përkushtim për avancimin e dialogut me Serbinë deri në arritjen e një marrëveshje përfundimtare me njohje reciproke.

Ministri i Jashtëm japonez, Tari Kono, ka theksuar se qeveria e tij ndjek me shumë vëmendje zhvillimet në Kosovë.

Në funksion të këtij interesimi është edhe vendimi për hapjen e Ambasadës së Japonisë në Prishtinë, e cila, siç u tha në takimin e dy bashkëbiseduesve, do të ndikojë në zgjerimin e mundësive të bashkëpunimit mes dy vendeve, sidomos në fushën e biznesit dhe investimeve.

Kryeparlamentari Veseli ka kërkuar nga ministri japonez që Japonia ta mbështesë Kosovën në procesin e përfshirjes në organizatat ndërkombëtare dhe në nismat e tjera globale.

Ministri Kono ka theksuar se qeveria e tij mban qëndrim proaktiv në këtë drejtim në mbështetje të Kosovës.

Rama: Maqedonia e Veriut, shtet mik i pazëvendësueshëm

TIRANË, 13 MARS - Shtet mik dhe strategjikisht i pazëvendësueshëm, e ka cilësuar kryeministri Rama, Republikën e Maqedonisë së Veriut, në konferencën e përbashkët për mediet pas takimit me homologun Zoran Zaev, i cili po qëndron për një vizitë njëditore në Tiranë. Rama theksoi se kjo vizitë vjen në momentin e një arritjeje madhështore historike, siç e cilësoi Marrëveshjen e Prespës dhe ndryshimin e emrit të Maqedonisë së Veriut si dhe nënshkrimin e protokollit të anëtarësimit në NATO. "Vini në Tiranë pas një arritjeje historike madhështore që është fryt i lidershipit tuaj dhe i lidershipit të mikut tonë të përbashkët, kryeministrit Cipras, Marrëveshjes së Prespës e cila i dha fund një ngërçi shumëvjeçar, hapi rrugën e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO dhe çliroi energjinë e madhe pozitive për ecurinë e mëtejshme në rrugën e përbashkët të integrimit në BE", theksoi Rama. "Për ne Republika e Maqedonisë së Veriut nuk është thjesht një vend fqinj, por një shtet mik dhe strategjikisht i pazëvendësueshëm dhe i patjetërsueshëm, marrëdhëniet me të cilin kultivohen tanimë përmes parimeve dhe vlerave më të mira që na bashkojnë si dy vende që i përkasin Evropës dhe që do të jenë së bashku në tryezën e familjes evropiane", theksoi kryeministri Rama.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Drejtori i Përgjithshëm për Çështje Politike në Ministrinë e Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Richard Moore, ka vizituar Republikën e Kosovës

Britania kërkon pezullimin e taksës

Pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Gjermanisë, edhe Britania ka kërkuar nga Kosova pezullimin e taksës ndaj produkteve serbe dhe boshnjake. Këtë kërkesë e ka parashtruar të mërkurën në Prishtinë drejtori i Përgjithshëm për Çështje Politike në Ministrinë e Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Richard Moore, gjatë takimeve që ka pasur me kryeministrin Ramush Haradinaj dhe me bashkëkryesuesit e ekipit negociator për bisedime me Serbinë, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti. Moore ka bërë me dije se Britania e mbështet dhe e inkurajon Kosovën për vazhdimin e dialogut dhe për arritjen e marrëveshjes finale me Serbinë e cila ka për qëllim njohjen e ndërsjellë



EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 13 MARS - Drejtori i Përgjithshëm për Çështje Politike në Ministrinë e Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Richard Moore, të mërkurën ka vizituar Kosovën, me ç'rast është pritur në takime të ndara nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj dhe drejtuesit e ekipit negociator për bisedimet me Serbinë, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti. Pas takimit, zëvendëskryeministri dhe bashkëkryesuesi i ekipit negociator për dialogun me Serbinë, Fatmir Limaj, ka konfirmuar se zyrtari britanik ka kërkuar nga Kosova që të pezullohet taksa doganore ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës në mënyrë që t'i jepet mundësi vazhdimit të dialogut. Ai ka theksuar se të gjithë zyrtarët ndërkombëtarë që po vizitojnë Kosovën po kërkojnë që të pezullohet taksa. "Tashmë është i njohur për të gjithë ne qëndrimi i të gjithë miqve që të gjendet rrugë për t'i dhënë mundësi vazhdimit të dialogut, të gjendet rrugë për t'i larguar pengesat, të cilat janë në dialog dhe këtë vazhdimisht na e kanë thënë edhe në Prishtinë, edhe në Bruksel. Të gjithë që vijnë, në një mënyrë apo tjetër, kërkojnë t'i jepet mundësi dialogut dhe të pezullohen pengesat, në këtë rast taksa. Ne në çdo rast përpiqemi të shpjegojmë që kushtëzimet nuk janë të mira në dialog dhe jemi të interesuar e të fokusuar që sa më shpejt të fillojë dialogu. Shpresoj që të dyja palët ta fillojnë dialogun sa më shpejt", është shprehur Limaj, duke shtuar se në këtë takim është biseduar edhe për përgatitjet që po i bën Kosova për vazhdimin e dialogut me Serbinë. Sipas Limajt, Britania e mbështet dhe e inkurajon Kosovën që të jetë pjesë e bisedimeve me qëllim, siç është shprehur ai, që të përmbyllen çështjet e hapura me Serbinë dhe procesi i dialogut të përfundojë me njohje të ndërsjellë.

Me këtë rast zëvendëskryeministri Limaj ka folur edhe për takimin e fundit të ekipit negociator në Bruksel. "Takimet tona në Bruksel merrni si diçka të zakonshme. Do të ndodhin shpesh. Nuk është takim i jashtëzakonshëm. Janë takime të rregullta. Kemi biseduar tema të cilat besojmë se do të jenë në proces. Kemi ngritur temën e të pagjeturve, dhunimet seksuale dhe dëmshpërblimet e luftës. Delegacioni është shumë unik", ka theksuar Limaj.

Zyrtari britanik Richard Moore të mërkurën është takuar edhe me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e fundit në vend. Në këtë takim kryeministri Haradinaj ka shprehur qëndrimin dhe përkushtimin e shtetit të Kosovës për arritjen e një marrëveshje finale dhe ligjërisht të obligueshme me Serbinë e cila ka për qëllim njohjen reciproke në kufijtë ekzistues. Ai ka falënderuar qëndrimin e Britanisë së Madhe për ruajtjen dhe mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit. "Kosova ka folur me një zë dhe për këtë ka votuar në Kuvend Ligjin dhe Platformën për Dialog, që përfaqëson unitetin e institucioneve tona. Mirënjohës për përkrahjen e vazhdueshme të Britanisë së Madhe për Kosovën dhe qëndrimin e palëkundur në ruajtjen dhe mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të saj", ka deklaruar Haradinaj.

Gjatë këtij takimi kryeministri e ka njoftuar zyrtarin britanik për të arriturat në Kosovë, për prioritetet e Qeverisë, për zhvillimin ekonomik, për fuqizimin e rendit dhe ligjit, për agjendën integruese të Kosovës si dhe për përkushtimin në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Duke vlerësuar rolin e Mbretërisë së Bashkuar dhënë Kosovës në të gjitha etapat, kryeministri Haradinaj ka kërkuar vazhdimin e mbështetjes së shtetit britanik për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. "Kosova ka nevojë për mbështetjen e vazhdueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe jemi të përkushtuar për fuqizimin e partneritetit në mes të dyja vendeve", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Ndërsa drejtori i Përgjithshëm për Çështje Politike në Ministrinë e Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Richard Moore, ka konfirmuar mbështetjen e Britanisë për Kosovën në të gjitha proceset e rëndësishme dhe rrugën evropiane.

Kuvendi i Kosovës të mërkurën ka mbajtur seancë plenare

Pozita dhe opozita i bëjnë thirrje presidentit t'i emërojë anëtarët e KQZ-së

Grupet parlamentare të pozitës dhe ato të opozitës i kanë bërë thirrje presidentit Hashim Thaçi që sa më shpejt t'i emërojë anëtarët e KQZ-së. Në seancën e thirrur nga opozita për debat parlamentar në lidhje me bllokimin e KQZ-së nga presidenti, përfaqësuesit e LDK-së dhe të LV-së kanë theksuar se këtyre partive u takojnë nga dy anëtarë të KQZ-së, në të kundërtën do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Por, përfaqësuesit e pozitës nuk janë pajtuar që LDK-së dhe LV-së t'i takojnë nga dy anëtarë në KQZ

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 MARS - Kuvendi i Kosovës të mërkurën, me kërkesë të 44 deputetëve, ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme, me një pikë të rendit të ditës: "Debat parlamentar në lidhje me bllokimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga presidenti", të cilën e ka drejtuar nënkryetari Xhavit Haliti. Në emër të iniciuesve të këtij debati ka folur deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Sami Kurteshi, i cili ka thënë se presidenti Thaçi ka pasur afat deri më 28 mars të vitit të kaluar ta përmbyllë këtë çështje. Megjithatë, Kurteshi ka thënë se KQZ-ja mbetet e bllokuar dhe jofunksionale. Ai ka treguar se LV-ja dhe LDK-ja më 17 prill 2018 i kanë dërguar nominimet për anëtarë të KQZ-së, të cilët nuk janë marrë parasysh nga Thaçi. "Presidenti kishte kërkuar material shtesë nga ne. Por, në heshtje e kishte pezulluar procedurën, duke e dërguar këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese, e cila e kishte shpallur të papranueshme kërkesën e presidentit", ka thënë Kurteshi. Ai e ka akuzuar presidentin Thaçi se po bën përpjekje t'i kontrabandojë anëtarët e KQZ-së në mënyrë antikushtetuese.

Kurteshi ka përmendur se si pasojë e bllokimit të punës së KQZ-së, 37 asamblistë dhe një deputet janë ende në pritje të certifikimit. Me këtë veprim, sipas tij, përveç shkeljes së Kushtetutës dhe ligjit nga ana e presidentit Thaçi, është dëmtuar edhe vullneti qytetar si dhe kanë dështuar shumë procese në KQZ. Në fund të fjalimit të tij, Kurteshi ka bërë thirrje që të votohet projektrezoluta, në të cilën, ndër të tjera, kërkohet që të funksionalizohet KQZ-ja.

Edhe shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se presidenti Hashim Thaçi, me mosveprimin e tij, po e bllokon funksionimin e KQZ-së. Ai ka thënë se procedura që duhet të ndiqet për emërimin e anëtarëve të KQZ-së është e qartë. "Gjashtë anëtarë emërohen nga grupet parlamentare që përfaqësojnë shumicën. Bazuar në zgjedhjet e qershorit të vitit 2017, grupet parlamentare më të mëdha janë PAN, LDK dhe LV", ka thënë Hoti, duke shtuar se me vonesën e emërimit të anëtarëve të rinj të KQZ-së, Thaçi ka bërë shkelje kushtetuese. Ai ka paralajmëruar se në rast të mosemërimit të kandidatëve nga ana e Thaçit, do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Duke folur në emër të grupit parlamentar të PDK-së, Elmi Reçica, ka thënë se ky debat është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në përgjegjësitë e presidentit Thaçi, të përcaktuara me Kushtetutë. Ai ka thënë se nga mosfunksionimi i KQZ-së është dëmtuar GP i PDK-së, pasi Rafet Rama është në pritje të certifikimit të mandatit të deputetit. Edhe Reçica ka kërkuar nga presidenti Thaçi që sa më shpejt

t'i emërojë anëtarët e KQZ-së, por ai e ka bërë të qartë qëndrimin se deputetët e PDK-së nuk do ta votojnë projektrezolutën e propozuar nga iniciuesit e kësaj seance.

Në vazhdim, në emër të grupit parlamentar të LV-së, ka folur Albulena Haxhiu, e cila ka thënë se, sipas Gjykatës Kushtetuese, grupeve parlamentare më të mëdha u takojnë nga dy anëtarë në KQZ. Ajo ka thënë se, sipas Kushtetutës, nuk është kompetencë e presidentit të bëjë pazare me territor por, sipas saj, ai e ka keqkuptuar pozitën që e mban. Haxhiu ka kërkuar nga Thaçi që sa më parë t'i emërojë dy anëtarë nga LV-ja, dy nga LDK-ja dhe dy nga PAN-i. Në të kundërtën, ajo ka paralajmëruar se çdo vendim tjetër do të kundërshtohet fuqishëm, duke e dërguar presidentin në Gjykatën Kushtetuese.

Rreth kësaj çështje, në emër të grupit parlamentar të AAK-së, ka folur edhe Ahmet Isufi, i cili, njëjtë sikurse deputetët e tjerë, ka kërkuar që sa më shpejt të funksionalizohet KQZ-ja. Në seancën e jashtëzakonshme për bllokimin e KQZ-së, deputetja Shqipe Pantina ka thënë se grupi parlamentar i PSD-së i mbështet kërkesat për funksionalizimin e KQZ-së. Ajo ka thënë se PSD-ja i bënë thirrje presidentit që sa më shpejt t'i emërojë anëtarët e KQZ-së. Pantina ka paralajmëruar se edhe disa institucione të tjera së shpejti do të mbesin jofunksionale, pasi u ka kaluar mandati anëtarëve të bordeve, për të cilat përgjegjësinë e ka Kuvendi. Edhe deputetët, ka thënë ajo, janë përgjegjës për këtë gjendje.

Në emër të grupit parlamentar të Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, nuk është pajtuar që LV-së dhe LDK-së t'i takojnë nga dy anëtarë në KQZ-së. Ai ka thënë se gjashtë grupet parlamentare ta kenë nga një anëtar në KQZ, kurse është pajtuar me opozitën që sa më shpejt të funksionalizohet KQZ-ja nga presidenti Thaçi. Edhe Albert Kinolli në emër të grupit parlamentar 6+ ka kërkuar nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, që ta përmbushë obligimin kushtetues dhe ligjor, që KQZ-ja, si një nga institucionet më të rëndësishme në vend, të jetë funksionale.

Gjatë diskutimeve, deputetët i kanë bërë thirrje presidentit Thaçi që ta funksionalizojë KQZ-në. Në mungesë të kuorumit, votimi i kësaj projektrezolute është shtyrë për një nga seancat e radhës.

Rreth 300 persona kërkohen nga Policia e Kosovës

Prishtinë, 13 mars - Qindra persona janë në kërkim nga Policia e Kosovës për vepra të ndryshme, duke filluar nga rastet e vjedhjeve e deri te personat e dyshuar për vepra që ndërlidhen me terrorizëm. Aktualisht janë 288 persona në kërkim nga Policia e Kosovës, ka treguar për "Radion Evropa e Lirë", drejtori i Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit (ILECU), Veton Elshani. Sipas tij, vetëm këtë muaj Policia ka arrestuar tre persona, të dyshuar për grabitje, vrasje dhe vepra që ndërlidhen me terrorizëm.

Megjithatë, në zyrën për media të Policisë së Kosovës nuk kanë dhënë shumë detaje për numrin e personave që janë në kërkim dhe për veprat që ata dyshohet se i kanë kryer. Po ashtu, nuk është sqaruar as në lidhje me dyshimet se në cilat vende dhe shtete fshihen këta persona sipas informatave që kanë organet e rendit.

Daut Hoxha, zëdhënës në Policinë e Kosovës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se kanë bashkëpunim të mirë edhe me vendet e tjera për realizimin e urdhërarresteve për persona të kërkuar. "Policia e Kosovës përmes një bashkëpunimi ndërinstitucional realizon urdhërarrestet për persona të kërkuar, qoftë në nivel vendi apo edhe realizime të urdhërarresteve për persona të tjerë, që kërkohen nga autoritetet e vendeve të tjera", ka thënë Hoxha.

Për Plator Avdiun nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), ky numër i madh i personave në kërkim paraqet problem për Policinë e Kosovës, kur dihet se Kosova ende nuk është pjesë e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë (Interpol). "Për Policinë e Kosovës kjo ka me qenë shumë problematike, duke marrë parasysh se nuk ka bashkëpunim ndërkombëtar policor me Interpolin, por edhe me vendet e tjera për shkak se Policia e Kosovës është e hendikepuar për shkak se nuk ka qasje në databazën e sistemit të Interpolit", ka thënë Avdiu.

Sipas tij, i vetmi sukses i Policisë së Kosovës në rrafshin ndërkombëtar është bashkëpunimi që ka me Agjencinë Evropiane të Policisë (Europol). "Kjo i ka mundësuar Policisë së Kosovës që pjesërisht të ketë suksese në disa prej rasteve, qoftë për arrestimin e personave të dyshuar për terrorizëm, ose të grupeve të ndryshme të trafikut të emigrantëve ku, fatmirësisht, Policia e Kosovës ka qenë pjesë e disa aksioneve të Europolit", ka thënë Avdiu.

Në uebfaqen zyrtare të Policisë së Kosovës figurojnë fotot e të kërkuarve, e që shumë prej tyre qëndrojnë aty prej vitesh. Në listën e të kërkuarve publikë janë: Radomir Kasaloviq, Dushan Jovanoviq, Ratomir Bozhoviq, Branisllav Rakiq, Petrit Salihu, Korab Zogjani, Agron Kryeziu, Ilir Abdullahu.

Disa persona që ende mbeten të paidentifikuar, por që shihen në fotografitë e publikuara nga policia, vazhdojnë të kërkohen si të dyshuar se kanë të bëjnë me rastin e revistës "Kosovo 2.0", ku u pengua promovimi i kësaj të fundit, ngjarje kjo që ndodhi më 14 dhjetor 2012 te Salla e Kuqe, Pallati i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë.

Më 20 nëntor të vitit të kaluar Kosova nuk kishte arritur të bëhet vend anëtar i Interpolit, derisa këtë vit ka aplikuar sërish që të anëtarësohet në këtë organizatë të rëndësishme.

Serbia po e pengon funksionimin e RYCO-s

Qendresa RAMA

Prishtinë, 13 mars - Republika e Kosovës këtë vit e kryeson njërin prej mekanizmave më të rëndësishëm të të rinjve siç është Zyra Rajonale e Bashkëpunimit për Rini (RYCO). Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, është përfaqësues i Qeverisë së Kosovës që kryeson RYCO-n këtë vit.

Ministri Gashi ka bërë me dije se të mërkurën ishte paraparë të merren disa vendime të rëndësisë së veçantë në takimin e Bordit të RYCO-s por, fatkeqësisht, mungesa e përfaqësuesit nga Serbia, i cili u shkarkua të martën nga Qeveria e Serbisë vetëm pse e kishte konfirmuar pjesëmarrjen në këtë takim, bëri që mbledhja e Bordit të RYCO-s të ndërpritet në mungesë kuorumi.

"Serbia me këtë veprim po e pengon funksionimin e RYCO-s dhe nuk po i përmbahet marrëveshjes së nënshkruar në Berlin përkitazi me funksionimin e këtij mekanizmi i cili ka për objektiv bashkimin e të rinjve dhe realizimin e projekteve të përbashkëta nga gjashtë vendet anëtare të RYCO-s (Kosova, Shqipëria, Bosnja, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia). Përkundër këtyre pengesave, ne zotohemi se do ta drejtojmë në mënyrën më të mirë të mundshme bordin e RYCO-s dhe nuk do të lejojmë që për politika ditore, Serbia ta bllokojë funksionimin e RYCO-s", ka thënë ministri Gashi.

Ministrja Hoxha: Çdo pengesë për rininë tonë është pengesë për integrimin euroatlantik

Prishtinë, 13 mars (ER) - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka takuar të mërkurën përfaqësuesit e Unionit Nacional të Studentëve të Republikës së Kosovës, me të cilët ka biseduar për procesin integrues të Kosovës. Ajo ka thënë se procesi integrues është kurora e angazhimit tonë politik dhe institucional, për vlerat dhe integrimin brenda vlerave të Bashkimit Evropian. "Jemi dhe do të mbesim pjesë e këtyre vlerave, historisë dhe kulturës evropiane", ka thënë Hoxha në takim me përfaqësuesit e Unionit Nacional të Studentëve të Republikës së Kosovës. "Ne nuk do ta humbim durimin edhe kur na bëhet padrejtësi dhe kur përdoren parime të ndryshme për çështje të njëjta, por ne do ta themi hapur se motoja, 'të bashkuar me diversitet', nuk është i plotë pa neve dhe vlerat e rinisë sonë e cila shkëlqen në të gjitha fushat e dijes, shkencës, sportit, kulturës e artit në nivel global. Të rinjtë tanë kanë qenë promotorë të ideve më përparimtare të kombit dhe shtetit tonë, andaj misioni i rinisë sonë sot vijon në fushat e reja të arritjeve globale. Gjithsesi, çdo pengesë për rininë tonë është pengesë e proceseve më të ndjeshme të vendit tonë në integrimin euroatlantik", ka thënë ministrja Hoxha.

Sali Bislimi takohet me parlamentarë të Zvicrës

Prishtinë, 13 mars (ER) - Drejtori i organizatës joqeveritare "Zëri Perëndimor i Kosovës", Sali Bislimi, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka bërë me dije se të mërkurën në parlamentin zviceran ka takuar këshilltarë federalë, kryetarë partish dhe deputetë të të gjitha partive politike. Ai ka treguar se temë diskutimi ishin rrjedhat politike dhe ekonomike në Kosovë. "Mbi 30 parlamentarë i njoftova për gjendjen në Kosovë, për padrejtësitë që po pësojmë në tema të caktuara, për liberalizimin e vizave vetëm me Zvicrën, për çështjet që frenojnë bashkëpunimin korrekt me vendin tonë dhe për vlerat perëndimore të Kosovës. Bisedë e veçantë ishte me kryetarin e SVP-së, Albert Rosti, kryetaren e Komisionit për Politikë të Jashtme në Parlamentin Zviceran, miken Elisabeth Schneider-Schneiter, miken Christa Markwalder, kryetarin e grupit miqësor në parlamentin zviceran Felix Muri dhe shumë përfaqësues të tjerë. Takimet do të vazhdojnë edhe javën tjetër për të mirën e dy vendeve tona që, pa dyshim, duhet shumë energji dhe atdhedashuri", ka thënë Sali Bislimi pas këtyre takimeve.

Kosova anëtarësohet në Organizatën Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës

Prishtinë, 13 mars (ER) - Republika e Kosovës është anëtarësuar si shtet anëtar në Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës dhe Resurseve Natyrore (IUCN), selia e së cilës ndodhet në Gland të Konfederatës Zvicerane.

Procesi i anëtarësimit në këtë organizatë është udhëhequr nga Ministria e Punëve të Jashtme në bashkërendim dhe koordinim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. "Me këtë anëtarësim, Kosova fuqizon edhe më tutje subjektivitetin e saj ndërkombëtar, ndërsa përfitimet për vendin do të jenë të shumanshme në çështjet që ndërlidhen me veprimtarinë dhe mandatin e organizatës", është bërë me dije në njoftimin e MPJ-së.

IUCN është organizata e vetme për mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar kështu që çështja e ruajtjes së natyrës të ketë zërin e saj në nivelet më të larta të qeverisjes ndërkombëtare.

IUCN | Member

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, i është përgjigjur Federica Mogherinit rreth taksës së vendosur ndaj produkteve të Serbisë

Haradinaj: Dialogu ka degraduar

Kryeministri Ramush Haradinaj ka kritikuar qasjen e përfaqësueses së lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, Federica Mogherini, në dialogun Kosovë - Serbi. Duke iu përgjigjur zyrtares së lartë të BE-së, e cila në Këshill të Sigurimit ka kërkuar heqjen e taksës, Haradinaj ka thënë se taksa dhe dialogu nuk duhet të ndërlidhen. Sipas kryeministrit, Mogherini ka lejuar që në këtë proces të ketë jotransparencë dhe moszbatim të marrëveshjeve të arritura



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 13 MARS - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, i është përgjigjur përfaqësueses së lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, Federica Mogherini, e cila nga Nju Jorku i ka kërkuar Kosovës ta heqë taksën ndaj mallrave serbe dhe ta lejojë vazhdimin e dialogut në mes të dy vendeve.

Kryeministri ka kritikuar qasjen e zyrtares së lartë të BE-së në dialogun Kosovë - Serbi, duke thënë se ka lejuar një proces jotransparencë dhe moszbatim të marrëveshjeve të arritura. "Pas deklaratave të djeshme të Federica Mogherinit, se taksa duhet të hiqet që të vazhdojë dialogu, unë ua kujtoj të gjithë vendimmarrësve se dialogu ka dalë nga binarët shumë kohë para se të vendosej taksa dhe kjo ka ndodhur kur Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Politikë të Jashtme ka lejuar që në këtë dialog jotransparent të diskutohet për ndërrim territoresh dhe me tolerimin e moszbatimit të marrëveshjeve të arritura. Këto janë arsyet se pse dialogu është ndalur", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook". Ai ka treguar gatishmërinë e Kosovës që të vazhdojë dialogu, duke thënë se procesi i dialogut dhe taksa janë dy procese të ndara. "Kosova është e përkushtuar që ky dialog të vazhdojë dhe mund të vazhdojë pa e lidhur me temën e tarifave", ka shkruar Haradinaj.

Një ditë më parë përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, Federica Mogherini, ka përsëritur nga selia e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, ku ndodhej për një seancë raportimi përpara Këshillit të Sigurimit, thirrjen drejtuar Kosovës për heqjen e taksës 100 për qind ndaj produkteve me origjinë nga Serbia. "Më lejoni ta falënderoj secilin prej jush për qasjen konstruktive të anëtarëve të Këshillit të Sigurimit ndaj dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës. Për rifillimin e plotë të bisedimeve, tarifat e vendosura nga Qeveria e Kosovës ndaj produkteve serbe duhen hequr. Ditën kur kjo do të ndodhë do të thërras menjëherë një takim të ri për dialogun në mënyrë që të arrihet një marrëveshje ligjërisht e detyrueshme, e cila do t'i adresojë të gjitha çështjet e jashtëzakonshme dhe do ta sjellin normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes të Prishtinës dhe Beogradit", ka thënë Mogherini.

Ajo ka përmendur rolin e saj si ndërmjetësuese e dialogut, duke shtuar se dialogu nuk i përkiste asaj, as Bashkimit Evropian apo ndonjërit përreth tryezës së Këshillit të Sigurimit, por më së shumti palëve diskutuese. "Ndaj, është në dorën e tyre gjetja e një marrëveshjeje që do të ishte e pranueshme dhe e përshtatshme për të dyja palët. Njëkohësisht, marrëveshja përfundimtare duhet të jetë në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe duhet ta ketë mbështetjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së", është shprehur Mogherini.

Duke theksuar se roli i palëve është dhe do të jetë vendimtar, shefja e politikës së Jashtme të BE-së ka shprehur gatishmërinë për t'i shtuar shkëmbimet me të gjithë anëtarët e Këshillit të Sigurimit në OKB mbi këtë çështje. Në fund, ajo është ndalur edhe te ngjarja e fundit historike që ndodhi në Ballkan. "Marrëveshja e Prespës është një tjetër shembull pozitiv i bashkëpunimit BE-OKB dhe një shembull i mrekullueshëm i lidershipit politik të të dyja vendeve, Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë", ka thënë ajo.

Haradinaj, Apostolova dhe Braathu diskutojnë për reformën zgjedhore

PRISHTINË, 13 MARS (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të mërkurën në takim shefin e OSBE-së në Kosovë, ambasadorin Jan Braathu dhe shefen e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, me të cilët ka biseduar për proceset zhvillimore në vend, me theks të veçantë për reformën zgjedhore.

Kryeministri Haradinaj ka theksuar përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për reformat e përgjithshme në vend, për forcimin e sundimit të rendit dhe të ligjit, për zhvillimin ekonomik, reforma këto të cilat do të jenë në shërbim të forcimit dhe rolit demokratik të institucioneve të vendit.

Gjatë takimit, kryeministri Haradinaj ka falënderuar institucionet e Bashkimit Evropian për rolin e tyre dhe ndihmën që kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin në procesin e reformave të përgjithshme në Kosovë, në të njëjtën kohë ka kërkuar mbështetjen e mëtejme për procesin e reformës zgjedhore përmes së cilës do të garantohej një gjithëpërfshirje politike dhe përfaqësim adekuat gjinor dhe etnik.

Duke theksuar orientimin euroatlantik të Kosovës, kryeministri Haradinaj vlerësoi se Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm dhe është duke punuar me përkushtim për përmbushjen e Agjendës së Reformave Evropiane dhe për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së.

Delegacioni i bizneseve amerikane diskuton mundësitë e bashkëpunimit me bizneset në Kosovë

Prishtinë, 13 mars (ER) - Përfaqësues të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë kanë pritur në vizitë delegacionin e bizneseve amerikane, i udhëhequr nga konsullja e përgjithshme e Republikës së Kosovës në Nju Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Teuta Sahatqija, ku bizneset anëtare patën rastin të shkëmbejnë mundësi bashkëpunimi me ato amerikane si dhe krijimin e lidhjeve të reja në sektorë të ndryshëm.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se ky takim është një mundësi e mirë për të ndërtuar dhe krijuar bashkëpunime të reja me kompanitë amerikane, si dhe një rast i veçantë që bizneset amerikane të njihen me disa nga storiet e suksesit të Kosovës. Zeka ka falënderuar Sahatqijen jo vetëm për punën e saj në përfaqësimin e Kosovës në Nju Jork, por edhe për ndërtimin e marrëdhënieve mes bizneseve si dhe nxitjen e relacioneve ekonomike në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës e që është edhe misioni i Odës Ekonomike Amerikane.

Konsullja e përgjithshme e Kosovës në Nju Jork, Teuta Sahatqija, ka thënë se prioritet kryesor mbetet krijimi i lidhjeve dhe partneriteteve në mes të bizneseve kosovare dhe atyre amerikane si dhe përmirësimi i imazhit të kompanive të Kosovës në tregjet ndërkombëtare. Ajo ka thënë se përmes kësaj vizite janë duke synuar bashkëpunime të reja për bizneset e vendit tonë, duke pasur parasysh kapacitetet e tyre, gjë e cila do të ndikojë edhe më tutje në krijimin e imazhit të Kosovës si një vend i përshtatshëm dhe atraktiv për investime të huaja.

Themeluesi dhe shefi ekzekutiv i kompanisë amerikane MD Squared Property Group,

Michael Mintz, ka thënë se kapacitetet e të rinjve dhe ndërmarrësve në Kosovë si dhe talenti i tyre janë të jashtëzakonshme. Ai ka thënë se janë mjaft të impresionuar me zhvillimin e bizneseve në Kosovë si dhe mbështetjen e sektorit privat dhe qeverisës për kultivimin e kapitalit njerëzor si dhe lehtësirave të tjera për zhvillimin e bizneseve në vend.

KEDS-i ndërtoi linjën e re të Tensionit të Lartë për 40 fshatra të Shalës së Bajgorës

Podujevë, 13 mars (ER) - Një rrjet komplet i ri tashmë shtrihet buzë rrugës që gjarpëron nga Mitrovica në drejtim të majave më të larta të Bjeshkëve të Shalës së Bajgorës. Linja e re e tensionit 10 kilovolt nis në Shupkovc dhe përfundon në Bajgorë. Ajo do t'i furnizojë me energji elektrike dyzetë fshatra të Shalës si Bare, Vidishiq, Rahovë, Zhazhë, Selac, Bajgorë, Kaqanollë, Kovaqicë, Vllahi etj. Përfitues janë mbi 1 700 familje dhe biznese të asaj ane me rreth 10 000 banorë.

Në vend të shtyllave të vjetra të pandërruara tash e 50 vjet, janë vendosur kabllo nëntokësore në gjatësinë mbi shtatë kilometra dhe pjesa tjetër në shtylla të reja të betonit. Tani rrjeti i ri mundëson shërbime më të sigurta dhe më kualitative. Gjithashtu, me realizimin e këtij projekti zvogëlohen edhe humbjet teknike dhe komerciale në largpërçuesin LP 10(20) kV. Rrjeti i vjetër ka qenë nëpër terrene malore - kodrinore dhe për këtë ka qenë shumë e vështirë për t'i evituar problemet në rrjet. Me ndërtimin e rrjetit të ri, traseja e të cilit është bërë përskaj rrugës rajonale, do të mundësojë qasjen më të lehtë për mirëmbajtje. Ndërtimi i këtij rrjeti ka mundësuar shkëputjen e konsumatorëve të KEDS-it të cilët janë furnizuar nga rrjeti elektrik i Trepçës.

Gjilani përfiton mbështetje nga MAPL-ja për ndërtimin e objektit të Kuvendit Komunal

Gjilan, 13 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, dhe sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Rozafa Ukimeraj, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për ndërtimin e objektit të Kuvendit Komunal në vlerë prej 1.9 milion eurosh.

Kryetari Haziri ka falënderuar MAPL-në për mbështetjen e madhe, duke thënë se deri tani Gjilani ka vuajtur për një objekt të ri që do t'i plotësonte nevojat e kuvendarëve, partive politike dhe mbi 300 shërbyesve civilë. Haziri ka theksuar se me ndërtimin e objektit të ri të Kuvendit Komunal performanca në punë do të ketë rritje të dukshme.

Nga java e ardhshme bizneset mund të regjistrohen në Komunën e Junikut

Junik, 13 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, në prani të zyrtarëve për regjistrimin e bizneseve, ka ndarë certifikatën e parë kompanisë "VB. Tofaj Sh.P.K", e cila nga sot biznesin e ka të regjistruar në këtë komunë si biznesi i parë i regjistruar në sistemin për regjistrime të bizneseve në Junik.

Kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, ka falënderuar për bashkëpunimin zyrtarët nga agjencia e regjistrimit të bizneseve. Ai ka theksuar se ky pavarësim i këtij dikasteri ka rëndësi të veçantë për komunën e Junikut pasi lehtëson procedurën e aplikimit të bizneseve të cilat veprojnë në këtë komunë.

Banka Botërore përkrah reformat në ATK

Prishtinë, 13 mars (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka pritur në takim një mision nga Banka Botërore, i cili ka për qëllim diskutimin e mundësive për asistencë teknike për t'i përkrahur reformat në administratën tatimore.

Gjatë këtij takimi drejtori Murtezaj i ka informuar përfaqësuesit e Bankës Botërore lidhur me zhvillimet e fundit në ATK dhe për planet e tij për arritjen e objektivave të planifikuara. Gjithashtu, drejtori i ka njoftuar lidhur me nevojat për asistencë në fusha të caktuara, me qëllim të përmirësimit dhe modernizimit të proceseve të punës. Me theks të veçantë u diskutua menaxhimi më i mirë i resurseve në dispozicion dhe hartimi i një strukture organizative efikase, e cila do të jetë në funksion të misionit të ATK-së.

Ndërsa përfaqësuesit nga misioni i Bankës Botërore ofruan përkrahjen e plotë për ATK-në, duke theksuar se kjo përkrahje do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Misioni i titulluar "Mbështetja e zbatimit të projektit të reformës në administratën tatimore" do të zgjasë nga 11 marsi deri më 15 mars.

Bizneset po hasin në probleme me transaksionet bankare

Përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) janë takuar të mërkurën me përfaqësues të Departamentit të Hetimeve në Policinë e Kosovës, ku kanë pohuar se krimet kibernetike kohët e fundit janë një dukuri shumë e theksuar te bizneset. Sipas përfaqësuesve të OAK-ut, bizneset kanë adresuar shqetësimet e tyre sa iu përket mashtrimeve që u janë bërë në raport me transaksionet ndërkombëtare dhe në këtë drejtim kanë kërkuar bashkëpunim nga policia për hetimin e këtyre rasteve

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

Prishtinë, 13 mars - Problemet e bizneseve që kanë të bëjnë me grabitjet, vjedhjet kibernetike gjatë transferimeve ndërkombëtare, qoftë me pagesën e faturave dhe mosliferimin e mallit apo ndërrimin e kontove nga hakerët, ishin arsyeja e takimit të përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës me drejtorin e Departamentit të Hetimeve në Policinë e Kosovës, Riza Shillova.

Gjatë këtij takimi kryetari i bordit të OAK-së, Skënder Krasniqi, ka theksuar se janë evidentuar shumë probleme që po i hasin bizneset gjatë operimit të tyre. Ai ka thënë se vjedhjet kohën e fundit po dëmtojnë rëndë bizneset. Krasniqi ka thënë se bizneset kërkojnë nga policia e Kosovës që të rritin gatishmërinë dhe efikasitetin, me qëllim që të parandalohen dhe minimizohen rastet e tilla. Gjithashtu, Krasniqi ka shtuar se është shumë i rëndësishëm krijimi i departamentit për mbrojtjen e bizneseve, të cilin e kanë edhe shtetet e tjera, pasi që çdo rrezikim i biznesit është rrezikim i të ardhmes.

Sa i përket aspektit kibernetik gjatë transferimeve ndërkombëtare, Krasniqi ka thënë se po ndodhin dy forma të mashtrimeve me të cilat po përballen bizneset: e para ka të bëjë me pagesën e faturave nga ana e biznesit dhe pastaj mosliferimin e mallit nga kompania përkatëse ku biznesi nuk po gëzon përkrahje nga shteti, çështja tjetër është ndërrimi i kontove nga ana e hakerëve, ku bizneset nuk kanë një sistem të mirë të mbrojtjes dhe sigurisë, duke u bërë kështu pre e këtyre mashtrimeve.

Sekretari i bordit, Diamant Elshani, ka pohuar se krimet kibernetike janë një dukuri shumë e theksuar te bizneset dhe përmes bashkëpunimit ndërkombëtar ato mund të zgjidhen. Elshani ka theksuar se OAK-u ka dosjet e bizneseve të cilat kanë adresuar shqetësimet e tyre sa iu përket mashtrimeve që u janë bërë bizneseve në raport me transaksionet ndërkombëtare andaj, sipas tij, bashkëpunimi drejt hetimit të këtyre rasteve dhe zgjidhjes së tyre është esencial.

Anëtari i bordit, Hysni Zogaj, u shpreh i shqetësuar për grabitjet e bankave në kohën e fundit, të cilat po ndikojnë negativisht jo vetëm te bizneset, por edhe te publiku. Ai ka theksuar se është shumë e rëndësishme që të ketë kontrolle më të mëdha nga ana e policisë.

Ndërkaq drejtori i Departamentit të Hetimeve në Policinë e Kosovës, Riza Shillova, ka falënderuar OAK-në për takimin dhe ngritjen e këtyre çështjeve, duke theksuar se këto janë edhe probleme dhe shqetësime të policisë. Shillova ka thënë se janë të hapur për bashkëpunim, pasi shqetësimet e bizneseve janë edhe shqetësime të tyre. Ai ka shtuar se rritja e partneritetit publiko-privat është pikësynim i policisë. Në fund të këtij takimi të dyja palët u pajtuan për organizimin e një punëtorie të përbashkët me qëllim që bizneset të informohen më hollësisht për mundësinë e mbrojtjes dhe bashkërisht të punojnë për eliminimin e këtyre problemeve.

Kosova ndalon operimin e aeroplanëve "Boeing"

Prishtinë, 13 mars (ER) - Aeroplanëve të llojit "Boeing 737-8 MAX" dhe "Boeing 738-9 MAX" u është ndaluar përkohësisht operimi mbi hapësirën ajrore të Kosovës. Këtë vendim e ka marrë Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, duke thënë se këta tipa të avionëve nuk do të operojnë përkohësisht për shkak "të hetimeve në vazhdim lidhur me pajisjet e mjeteve ajrore 'Boeing 737-8 MAX' dhe 'Boeing 738-9 MAX'", thuhet në njoftim.

Edhe Bashkimi Evropian, Norvegjia, Australia, Kina, Malajzia, Singapori, Indonezia, Brazili, Meksika, India njoftuan se kanë ndaluar këtë lloj të aeroplanit për të fluturuar në hapësirat e tyre ajrore deri në një njoftim të ardhshëm. Edhe shumë shtete të tjera kanë marrë vendim për ndalimin e fluturimeve të këtyre tipave të aeroplanëve, pas rrëzimit të një aeroplani nga Etiopia më 10 mars, ku 157 udhëtarë në bord humbën jetën nga rrëzimi i tij.

ORA E HISTORISË

Homazh mësuesit patriot, Selim Berisha (1950-1999), që u bë edhe vetë pjesë e historisë



Prof. dr. Agim VINCA

Sot e 20 vjet më parë, më 20 mars të vitit 1999, kur Kosovës i kanosej një hekatombë e re nga pasardhësit e ardhacakëve të dikurshëm të Karpateve, në fshatin Drenofc dhe Barilevë të Prishtinës ndodhi një ngjarje e pazakontë, që do të mbahet mend brez pas brezi: në një luftë krejtësisht të pabarabartë me makinerinë luftarake të ushtrisë serbe, ra heroikisht Dëshmori i Kombit prof. Selim Berisha.

Deri atë ditë prof. Selim Berisha, arsimtar i historisë në Shkollën Fillore "Ali Kelmendi" të këtij fshati, ua kishte mësuar nxënësve të vet historinë, kurse atë ditë kishte vendosur (e kishte bërë mendjen top) të hynte vetë në të; të bëhej pjesë e historisë më të re të Kosovës.

Deri atë ditë prof. Selim Berisha u kishte folur nxënësve të vet për Skënderbeun e Ismail Qemailin, për Mic Sokolin e Sefë Kosharen, për Bajram Currin e Hasan Prishtinën, për Çerçiz Topullin e Themistokli Gërmenjin, për Azem e Shotë Galicën dhe sa e sa heronj të tjerë të kombit, përfshirë këtu edhe komandantin legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jasharin, kurse atë ditë kishte vendosur (e kishte bërë mendjen top) ta linte ditarin e mësuesit të historisë dhe të hynte edhe vetë në analet e saj, duke u radhitur në radhët e atyre që dhanë jetën për lirinë e Kosovës; në radhët e atyre që ne ua kemi borxh këtë grimë liri që gëzojmë sot.

Dhe, ashtu ndodhi. Në mëngjesin e 20 marsit, kur regjimi kriminal i Beogradit, që pas refuzimit të Marrëveshjes së Rambujesë dhe si rezultat i forcimit të UÇK-së po sillte përforcime të reja në Kosovë, ndërmjet një ekspedite ndëshkuese ndaj katër fshatrave të Prishtinës, Drenofc, Barilevë, Breznicë dhe Prugovc, prof. Selim Berisha bëri një sfidë të rrallë, një gjest të denjë për respekt: aktin e rezistencës individuale kundër okupatorit. Edhe pse pa ndonjë përgatitje të madhe ushtarake dhe pa pajimet e duhura për luftë moderne, ai vendosi t'u dilte përballë forcave ushtarako-policore serbe dhe të luftonte me to deri në pikën e fundit të gjakut. Ai vetëm, kurse ato me qindra e mijëra; ai me një pushkë të thjeshtë e ca municion, kurs ato me tanke e autoblinda!

Prof. Selim Berisha, sigurisht, ishte i vetëdijshëm se nuk mund ta fitonte këtë betejë tmerrësisht të pabarabartë, por ai kishte vendosur të mos dorëzohej i gjallë. As epërsia e madhe e kundërshtarit e as lebetitjet e fëmijëve dhe vaji i nënave nuk e ligështuan prof. Selimin. I barrikaduar në shtëpinë e vet, ai luftoi plot dy orë me makinerinë ushtarako-policore të okupatorit derisa ra në mbrojtje të pragut të shtëpisë dhe të dinjitetit kombëtar dhe njerëzor, me shpresë se gjaku i tij do të ishte një kontribut i vogël në përpjekjet shekullore të këtij populli për të dalë nga zgjedha e robërisë.

Do thënë menjëherë se akti heroik i prof. Seli Berishës nuk ishte një veprim i rastit e as trill i një njeriu aventurier. Jo. Aspak. Ishte një veprim plotësisht i vetëdijshëm; veprim i një njeriu që luftën për liri e kishte filluar shumë kohë më parë, duke e zhvilluar atë në shumë fronte - si mësimdhënës, si veprimtar, si publicist, si atdhetar. Flijimi i 20 marsit në Drenofc të Prishtinës ishte akt i një njeriu me vetëdije të lartë kombëtare dhe politike, akt i një veprimtari e atdhetari të vërtetë, i cili ishte thellësisht i bindur se liria nuk fitohet ndryshe pos me gjak e sakrifica sublime.

Aktet e tilla të rezistencës individuale përballë furisë së pushtuesve nuk janë të panjohura në kujtesën kolektive. Te romani i njohur i Kadaresë, "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", më e famshmja vepër e letërsisë shqipe, ka një personazh që quhet Nik Martini. Është një personazh episodik, por që mbahet mend gjatë, sepse është personazh simbol. Kur merr vesh se trupat pushtuese po zbarkonin nga deti, malësori Nik Martini kap pushkën dhe del në breg të luftojë kundër tyre ose, si thotë ai, "të qesë pushkë". Natyrisht, vetëm, duke bërë një rezistencë dasmorësh në pika të ndryshme. Kur i mbarohen fishekët, malësori trim Nik Martini, për të cilin në roman thuhet se nuk ka varr, por vetëm një këngë, ngrihet në këmbë e lëshon një vikamë të fortë dëshpëruese për fatin e atdheut, derisa korret nga plumbat e grihet nga kamat.

Dikush mund të thotë me të drejtë se ky krijim artistik është pjellë e imagjinatës së shkrimtarit. Dhe, ashtu është. Por, akti i Mujo Ulqinakut, një kapteri të thjeshtë të Ushtrisë shqiptare (me origjinë nga Ulqini), i cili më 7 prill 1939, në Durrës, bëri pothuajse i vetëm një rezistencë shembullore kundër trupave fashiste italiane që po zbarkonin në Shqipëri, edhe pse komandanti i tij supreme, NMT Zog I, e kishte braktisur jo vetëm frontin, por edhe Atdheun, a nuk është një gjest me përmasa pak a shumë të ngjashme, mitike-legjendare, si ai i Nik Martinit të romanit? Nuk ka dyshim se po.

78 vjet më vonë, në një kohë tjetër dhe në rrethana krejtësisht të tjera, prof. Selim Berisha i Drenofcit të Prishtinës, edhe pse me profesion mësues e jo ushtarak, do ta përsërisë në mënyrën e vet epopenë e Nik Martinit e të Mujo Ulqinakut. Duke mos dashur të largohet nga shtëpia dhe fshati i tij si shumë të tjerë, ai lufton vetëm, dy orë të plota, me trupat serbe që po bëheshin gati për qërim përfundimtar të hesapeve me shqiptarët e Kosovës. Mirëpo, prof. Selim Berisha, edhe pse ishte vetëm, nuk ishte i vetmuar. Ky nuk është një paradoks poetik, por një fakt historik. Jo larg pikës nga e cila ai bënte aktin e rezistencës së vet individuale, në malet e Drenicës, të Llapit e të Dukagjinit dhe të krejt Kosovës, por edhe brenda në fshatra dhe qytete, vepronte një forcë ushtarake, politike dhe morale, e cila luftonte në mënyrë të organizuar për lirinë e Kosovës. Kjo forcë, që tanimë e njihte bota mbarë, që quhej Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe, kishte arritur të legjitimohej dhe, si e tillë, të bëhej partnere serioze e bashkësisë ndërkombëtare në tryezën e bisedimeve dhe aleate në front e fuqisë më të madhe ushtarake në botë, Aleancës Veriatlantike. Ishte UÇK-ja legjendare ajo që e kishte çuar larg zërin e Kosovës dhe kishte frymëzuar edhe aktin e rezistencës individuale të prof. Selim Berishës.

Mësuesi atdhetar i Drenofcit dhe mbarë Shqiptarisë, prof. Selim Berisha, që kishte kryer studimet e historisë në Universitetin e Prishtinës dhe që kishte derdhur vite me radhë mundin dhe djersën e tij për edukimin e brezit të ri, konsideronte se pas gjithë asaj që kishte ndodhur në Kosovë, sidomos me farsën e rezistencës paqësore dhe të mbjelljes sistematike të frikës nga armiku në popull, edhe në këtë mënyrë mund ta lante borxhin ndaj Atdheut, duke i treguar botës se shqiptarët janë njerëz që jo vetëm dinë të ikin nga shtëpitë e veta, natyrisht si pasojë e dhunës, por edhe të vdesin në prag të tyre. Tri ditë para se forcat e NATO-s t'i lëshonin bombat e para mbi caqet ushtarake serbe, për ta ndalur agresorin që synonte të bënte gjenocid mbi një popull të tërë në fund të shekullit XX dhe në mes të Evropës, prof. Selim Berisha bëri aktin e sakrificës sublime: ra duke luftuar me pushkë në dorë në prag të shtëpisë.

"Doemos do vdesim në shtrat në mos rënçim në prag të shtëpive tona", thoshte i madhi De Radë në njërën nga poemat e veta të mëdha historike kushtuar Motit të Madh.

I edukuar në këtë frymë, mësuesi i historisë, prof. Selim Berisha, i cili 25 vjet rresht e kishte ligjëruar këtë lëndë para nxënësve të vet, zgjodhi alternativën e rënies në prag të shtëpisë, të këtij simboli të madh, universal, të jetës, ekzistencës dhe dinjitetin njerëzor. Në këtë mënyrë ai mbajti orën e vet të fundit të historisë, më të bukurën dhe më të paharruarën, duke dhënë shembullin personal se si duhet Atdheu, se si jetohet, luftohet dhe vdiset për të.

E ç'mund të bënte tjetër ky njeri në orën e vet të fundit të historisë, më 20 mars 1999 (kur gjatë orëve të tjera e ka treguar në mënyrë teorike se si mbrohet Atdheu, kurse në orën e fundit në mënyrë praktike)?

Lavdi emrit dhe veprës së dëshmorit prof. Selim Berisha dhe të gjithë atyre që ranë për lirinë e Kosovës!

Malishevën shumë shpejt pritet ta vizitojnë udhëheqës të lartë politiko-ushtarakë nga Zvicra

MALISHEVË, 13 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur në takim Njësinë e LMT-së në Malishevë të përfaqësuar nga L. Sutter. Kryetari Begaj ka shprehur gatishmërinë për takime të rregullta me Njësinë e LMT-së në Malishevë për shkëmbim temash të ndryshme me interes për qytetarët malishevas. Kurse përfaqësuesit nga Njësia e LMT-së në Malishevë e kanë njoftuar kryetarin Begaj me planin dhe objektivat që kanë, si dhe kanë bërë me dije se gjatë këtij viti Malishevën do ta vizitojnë udhëheqës të lartë politiko-ushtarakë të shtetit zviceran, me qëllim të njohjes dhe bashkëpunimit në shumë sfera të interesit të ndërsjellë. Në fund u pajtuan t'i fillojnë parapërgatitjet për këto vizita si nga komuna, po ashtu edhe nga Njësia e LMT-së.

E jashtëzakonshme

Dhia zgjedhet 'kryebashkiake' e qytetit

Banorët e një qyteti në shtetin e Vermontit në ShBA zgjodhën një kryebashkiak të ri të veçantë, një dhi të quajtur Lincoln. Dhia u betua në detyrën e re të martën. Menaxheri i qytetit Fair Haven, Joe Gunther, vendosi të zhvillojë zgjedhje për një kryebashkiake të kafshëve në përpjekje për të mbledhur para për të zëvendësuar një shesh lojërash në shkollë. Banorët propozonin kafshën e tyre për karrigen e kryetarit të komunës dhe në këmbim dhuronin pesë dollarë për sheshin e lojërave. Kryebashkiakja është një dhi trevjeçare me emrin Lincoln. Dhia mundi një qen me emrin Sammie me vetëm dy vota.

FOTO E DITES

Një banor i cili ndihmonte zjarrfikësit mban një biçikletë të djegur pas një zjarri në Toi Market në Kenia. /AFP/

E rrallë

Mbijetesa e pabesueshme në oqean, vetëm nga xhinset



Ajo arriti të shpëtonte në ujërat e oqeanit në Zelandën e Re falë xhinseve. Aventura e një turisteje gjermane e quajtur Arne Murke është e pabesueshme. Ajo ishte në oqean duke lundruar në bordin e një anije prej 12 metrash bashkë me vëllanë e saj, Helge. Ata do të lundronin nga Zelanda e Re për në Brazil. Sidoqoftë, për fat të mirë, Arne kujtoi një truk që kishte mësuar vite më parë, i cili lejoi t'i transformonte pantallonat në një pajisje shpëtimi për të qëndruar mbi ujë. "Pasi hoqa xhinset, i kam bërë nyje në fund të këmbëve dhe i kam fryrë ato. Pasi u mbushën me ajër, dolën mbi ujë. Kështu, pata një jelek shpëtimi", ka treguar ajo.x

BARSOLETA E DITËS

Një polic i shëndoshë qëndron para çerdhes së fëmijëve dhe papritmas vjen një edukatore dhe e pyet:
- Më falni, po prisni fëmijë?
- Jo more, gjithë këtë bark e kam nga birra, i përgjigjet polici.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Nuk keni asnjë moment të lirë gjatë ditës së sotme. Kjo do t'ju kushtëzojë të anuloni një ftesë që kishit kohë që e prisnit.

DEMI
Sot po kërkoni përkëdhelje dhe keni mjaft dëshirë të qëndroni me njerëzit tuaj të dashur. Disa do ta kenë mundësinë t'ju kënaqin.

BINJAKËT
Keni mjaft situata ngërçi sot sa i përket një problemi në fushën e biznesit. Do të konsultoheni me ekspertë të ndryshëm për një rrugëzgjidhje.

GAFORRJA
Doni gjithmonë dikë t'ju udhëheqë në rrugën tuaj. Kjo ju ka bërë persona me shumë pak iniciativë në përgjithësi.

LUANI
Sot zgjidhni çështjet që keni më për zemër dhe përkushtojuni vetëm atyre. Optimizmi që ju karakterizon do të bëjë që gjithçka të buzëqeshë sot për ju.

VIRGJËRESHA
Sot do të bëni paqe me partnerin në lidhje me një debat të shkuar dhe do të riktheheni buzagaz si më parë.

PESHORJA
Ndiheni pak të plogësht si pasojë edhe e kohës. Qëndrimi në shtëpi do të ishte idealja, por ju duhet të dilni për angazhime të tjera.

AKREPI
Do të gjendeni midis një zgjedhjeje të vështirë sot. Miqtë apo partnerin, të dyja palët kanë nevojë për ju për momentin.

SHIGJETARI
Emocionet do të dominojnë në ditën tuaj sot. Të mira ose të këqija gjithsesi do të keni mjaft luhatje emocionale përgjatë ditës.

BRICJAPI
Sot jeni ekspert i fjalës dhe do të dini të shprehni çdo gjë në mënyrën më të mirë të mundshme për të tjerët. Planet tuaja do të perceptohen shumë thjesht.

UJORI
Ndiheni disi të kushtëzuar sot nga familjarët tuaj ose nga partneri. Megjithëse janë dashuria juaj, si tipa të lirë që jeni, sot do të ndiheni brenda kornizave.

PESHQIT
Sot ditë e qetë për ju, por me mjaft projekte të realizuara. Kjo ju ka dhënë siguri financiare që do të pasqyrohet në çdo veprim tuajin.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	ARSENAL - RENNES	1-1	INTER - FRANKFURT	1-1	BENFICA - DINAMO Z.	1-1

Topalli: Ballkani pa problem e siguron mbijetesën

Aktualisht skuadra e Ballkanit është në zonën e barazhit, por sulmuesi Jetmir Topalli beson se kjo skuadër nuk do të bjerë nga IPKO Superliga. "Këtë vit Superliga është bërë shumë interesante dhe deri në fund të sezonit nuk dihet se çfarë do të ndodhë, por besoj shumë se me punën që kemi bërë dhe do të bëjmë edhe në ndeshjet e ardhshme, do të arrijmë të mbijetojmë pa ndonjë problem", ka thënë Topalli për "Epokën e re"

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 13 mars - KF Ballkani aktualisht pozicionohet në vendin e nëntë në renditjen tabelore të IPKO Superligës së Kosovës në futboll. Skuadra që përfundon kampionatin në këtë pozicion i duhet t'i luajë ndeshjet e barazhit për ta siguruar mbetjen në elitë, por sulmuesi i skuadrës nga Suhareka, Jetmir Topalli, për "Epokën e re" ka thënë se Ballkani nuk do të bjerë nga elita. Sulmuesi perspektiv është i mendimit se rezultatet, sidomos në sezonin pranveror, kanë mundur të jenë edhe më të mira, pasi në këtë klub ka shumë lojtarë me përvojë. "Duke pasur parasysh se kemi lojtarë me përvojë dhe të dëshmuar në ligën tonë, nuk janë ato rezultate që ne i kërkuam dhe që i merituam, por nganjëherë edhe fati nuk ishte në anën tonë dhe ky është realiteti. Këtë vit Superliga është bërë shumë interesante dhe deri në fund të sezonit nuk dihet se çfarë do të ndodhë, por besoj shumë se me punën që kemi bërë dhe do të bëjmë edhe në ndeshjet e ardhshme do të arrijmë të mbijetojmë pa ndonjë problem", ka thënë Topalli.
Sulmuesi në fjalë është autor i katër golave në këtë edicion, kurse ka folur edhe për ndeshjen e radhës që Ballkani e zhvillon në fundjavë ndaj Llapit në stadiumin "Zahir Pajaziti". "Dihet se ndeshja ndaj Llapit do të jetë shumë e vështirë duke pasur parasysh se është duke luftuar për titull dhe është ekip i përbërë mirë dhe ka lojtarë cilësorë, por ne jemi përgatitur maksimalisht për këtë ndeshje dhe duam të paktën një pikë. Mungesa e vetme për ne në këtë ndeshje është Blend Baftiu, por ne

të tjerët do ta japim maksimumin", ka shtuar ai.
Skuadra e Ballkanit pozicionet në vendin e nëntë me 28 pikë, kurse nga 22 ndeshje ka regjistruar tetë fitore, katër barazime dhe dhjetë humbje.

SHKURT

Përforcohen Ylli dhe Trepça

KB Golden Eagle Ylli ka paraqitur për regjistrim lojtarin ndërkombëtar Bambale Mbulatale Emmanuel Osby nga ShBA-ja, i cili së fundi është paraqitur në Ligën Pro B në Francë. Lojtari i lartpërmendur mund të regjistrohet në FBK dhe të paraqitet për skuadrën e Yllit pas plotësimit të kritereve në bazë të Rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve në FBK. Edhe KB Trepça ka paraqitur për regjistrim lojtarin ndërkombëtar Zachary Alexander Reynolds nga ShBA-ja i cili së fundi është paraqitur në Ecuador.

Skënderbeu huazon Gavazajn te Dinamo

Enis Gavazaj do ta vijojë karrierën në kampionatin bjellorus. Sulmuesi i kombëtares shqiptare është prezantuar të mërkurën nga skuadra e Dinamos së Minskut. Gavazaj qëndroi për më shumë se një javë në prova te skuadra bjelloruse, ku bindi me paraqitjet e tij në disa teste miqësore. Klubi ka bërë me dije se 23-vjeçari është huazuar nga klubi i Skënderbeut deri në përfundim të gjysmës së parë të kampionatit. Gavazaj do ta veshë fanellën me numrin 11 në ekipin e tij të ri.

Gashi flet pas largimit nga Colorado

Shkëlzen Gashi ishte pjesë e Colorado Rapidsit derisa klubi vendosi mos ta kishte pjesë të skuadrës sulmuese. Ai u largua nga Bazeli dhe në mënyrë surprizë firmosi për ekipin amerikan. Fillimi ishte pozitiv, por aventura e tij u mbyll që në fillim të këtij, për shkak edhe të pagës së lartë që ai përfitonte. Në një prononcim të shkurtër për "The Denver post", futbollisti i kombëtares sonë shprehet se e kishte kuptuar më parë këtë situatë. "Nga fillimi i parapërgatitjeve të sezonit kisha leje për t'u stërvitur vetëm me skuadrën e të rinjve. Aty e kuptova se klubi dhe unë do të shkonim në rrugë të ndryshme. Megjithatë, edhe në këtë situatë qëndrova si profesionist, madje shënova dy gola në dy ndeshje", ka thënë Gashi.

Uji "Rugove", sponsor i FBK-së

Prishtinë, 13 mars - Uji "Rugove" do t'i furnizojë të gjitha aktivitetet që organizohen nga Federata e Basketbollit të Kosovës, përfshirë këtu Përfaqësuesen A të Kosovës, përfaqësueset e reja të Kosovës, Kampin Nacional të FBK-së, FIBA U20 Kampionatin Evropian, Divizionin B në konkurrencën e femrave që do të mbahet në Prishtinë, turnetë ndërkombëtarë të kategorive të reja në të dyja konkurrencat, klinikat për trajnerë dhe për gjyqtarë. Marrëveshja për këtë sponsorim është arritur të mërkurën kur është nënshkruar marrëveshja në mes të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe korporatës "Rugova", produkti uji "Rugove". Në emër të FBK-së kontratën e ka nënshkruar Elvira Dushku, sekretare e Përgjithshme, kurse në emër të Korporatës "Rugova", produkti uji "Rugove", kontratën e ka nënshkruar përfaqësuesja e kësaj kompanie, Leana Rexhepi.

Zyrtarët e FIBA-s vijnë në Kosovë për inspektim të palestrave

Prishtinë, 13 mars - Më 18 dhe 19 mars 2019 në Prishtinë do të qëndrojnë Radmila Turner dhe Sinan Taze, që të dy zyrtarë të lartë në FIBA Evropë. Arsyeja e vizitës së tyre është inspektimi i hoteleve dhe palestrave të paraqitura nga Federata e Basketbollit të Kosovës për FIBA U20 Kampionatin Evropian, Divizioni B (Femrat) që do të organizohet prej 3 deri më 11 gusht 2019 në Prishtinë. Federata e Basketbollit të Kosovës i ka paraqitur dy palestra për këtë aktivitet, palestrën e vogël në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve si dhe palestrën "1 Tetori". Shtetet pjesëmarrëse në këtë kampionat do të jenë: Kosova, Islanda, Kroacia, Izraeli, Ukraina, Irlanda, Britania e Madhe, Danimarka, Turqia, Rumania, Finlanda, Greqia dhe Bullgaria. FBK-ja në vitin 2018 ishte organizatore e FIBA U18 Kampionatit Evropian, Divizioni C, në të cilin Përfaqësuesja e Kosovës triumfoi në mesin e nëntë shteteve, duke u shpallur kampione dhe duke avancuar një divizion më lart, pra në atë B që nga viti 2019.

Arsenalit i duhet shumë punë për ta përmbysur Rennesin

LONDËR, 13 MARS - Sonte zhvillohen ndeshjet kthyese në Ligën e Evropës. Kualifikimin për çerekfinale në këtë garë thuajse e kanë siguruar Chelsea dhe Napoli pasi kanë fituar ndeshjet e para me rezultat 3-0 ndaj Dynamo Kyivit dhe Salzburgit. Punë e vështirë e pret skuadrën e Arsenalit, e cila ka për detyrë ta përmbysë rezultatin e ndeshjes së parë që e humbi nga Rennesi (3-1).

Ekipi i dy futbollistëve shqiptarë, Granit Xhaka e Shkodran Mustafi, pati një paraqitje të mirë në fundjavë në derbin ndaj Manchester Unitedit dhe synon të njëjtën gjë ta bëjë edhe ndaj francezëve për ta arritur kualifikimin. Edhe skuadra e Sevillas, që ishte pritur të jetë një nga favoritet për të triumfuar në këtë garë, ka dështuar në përballje me Slavia Pragën (2-2), kurse tash i duhet shumë punë për ta siguruar kualifikimin. Punë më të lehtë pritet të ketë skuadra e Interit, e cila e pret Eintracht Frankfurtin.

LIGA E EVROPËS

18:55 Dynamo Kyiv - Chelsea	(0-3)
18:55 Krasnodar - Valencia	(2-2)
18:55 Salzburg - Napoli	(0-3)
21:00 Arsenal - Rennes	(1-3)
21:00 Benfica - Dinamo Z.	(0-1)
21:00 Inter - Eintracht F.	(0-0)
21:00 Slavia Prague - Sevilla	(2-2)
21:00 Villarreal - Zenit	(3-1)

LeBroni, vendimtar në fitoren e lakersave

CHICAGO, 13 MARS - Lakersi rikthehet te fitorja në kampionat pas pesë humbjesh radhazi, duke mundur 123-107 Chicagon. Fitorja e ekipit kalifornian u vendos në periodën e fundit, me të zakonshmin LeBron Jamesi që ishte lider në fushë. Ai realizoi 36 pikë e 10 rebounde, mbështetur edhe nga Kuzma me 21 pikë. San Antonio fitoi 112-105 ndaj Dallasit në derbin teksan, një takim i dominuar dhe fituar me meritë nga Spursi, që pati epërsi gjatë gjithë kohës. Brunsoni me 34 pikë ishte shënuesi më i mirë për Dallasin, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Në kahun tjetër, DeRozan realizoi 33 pikë, mbështetur nga Aldridge me 28 pikë e White me 23. Portlandi befason clippersat, duke fituar 125-104 në Los Angelos. Për Clippersin shkëlqeu Harrell, autor i 22 pikëve e 11 reboundeve, por që mbetën për statistikë. McCollum, që realizoi 35 pikë, ishte lider për Portlandin, ndërsa Lillardi e Nurkiqi realizuan nga 20 pikë, raporton "Telesport". Milwaukee ruan kreun në Lindje, pas fitores 130-113 ndaj New Orleansin, takim ku miqtë patën epërsi në fushë gjatë gjithë kohës. Giannisi me 24 pikë dhe Middletoni me 23 bënë dallimin në parket, duke i bërë të pavlefshme 23 pikët e Randles për vendësit. Fiton edhe skuadra e Denverit, që mundi 133-107 Minnesotan, takim ku dallimin e bëri Murray me 30 pikë. Philadelphia, falë 26 pikëve të Simmonsit, mundi 106-99 Clevelandin.

REZULTATET

Indiana - New York	103-98
Philadelphia - Cleveland	106-99
Chicago - Lakers	107-123
Dallas - San Antonio	105-112
New Orleans - Milwaukee	113-130
Denver - Minnesota	133-107
Clippers - Portland	104-125

SHKURT

Ronaldo: Kjo është arsyeja pse më bleu Juventusi

Pas fitores 3-0 ndaj Atletico Madridit, për "Sky Sport Italia" foli edhe vetë protagonisti kryesor i ndeshjes, Cristiano Ronaldo. Ai shprehet se ky është mentaliteti që duhet në Ligën e Kampionëve dhe Juventusi është në rrugën e duhur, bashkë me të në ekip. "Duhej të ishte një natë speciale dhe kështu ndodhi. Jo vetëm për golat e mi, por edhe për skuadrën dhe lartësinë e pabesueshme në fushë. Ky është mentaliteti që duhet në Ligën e Kampionëve dhe ne jemi në rrugën e duhur. Prandaj Juventusi më ka marrë, për ta ndihmuar në netë të tilla magjike si kjo. Atletico është vërtet një skuadër e fortë për t'u përballur, por ne jemi të fortë dhe sot e provuam. Është ende herët të flasim për finale", ka deklaruar Ronaldo.

Simeone: Juve e meritoi kualifikimin

Nuk kërkon justifikime Diego Simeone pas humbjes 3-0 me të cilën Juventusi eliminoi Atletico Madridin nga Liga e Kampionëve. "Ata ishin më të zotë", pranon trajneri argjentinas në fund të ndeshjes. "Në pjesën e parë ne nuk ishim në gjendje që të gjenim pozicionimet e duhura, ndërsa ata erdhën disa herë në zonën tonë dhe vazhdonin të krijonin rreziqe dhe neve na duhej të mbroheshim". Kur e pyesin nëse u surprizua nga taktika e italianëve, me Emre Canin në fazën e ndërtimit të lojës, i cili kthehej deri në nivelin e mbrojtësve, ai përgjigjet: "Ne i kishim përgatitur të gjitha situatat. Duhet t'i urojmë ata. Ishin më të zotë se ne. Shkoi kështu dhe e merituan kualifikimin. Ndonjë gabim e bëmë. Ata u treguan më të saktë taktikisht, në topat e dytë, në gjithçka".

Icardi në bisedime me Realin

Vazhdon të mbetet e paqartë e ardhmja e sulmuesit Mauro Icardi. Mirëpo "Tuttomercatoweb" raporton se sulmuesi është në bisedime me skuadrën e Real Madridit. Interesim për argjentinasit ka shfaqur edhe skuadra e Napolit si dhe Juventusi. Reali e ka rikthyer trajnerin Zinedine Zidane dhe tash synon të bëjë edhe përforcime. Një prej tyre është edhe sulmuesi i Interit.

Tucheli: Gjithkush i dëshiron Mbappen dhe Neymarin

Florentino Perez ka pranuar se do të preferonte ta transferonte Kylian Mbappen. Për këtë të fundit, presidenti i Real Madridit ka kërkuar ndihmën e trajnerit Zinedine Zidane, i cili u rikthye në skuadër pas dhjetë muajve. "Unë e kuptoj se të gjithë i dëshirojnë Neymarin, Mbappen apo [Marco]. Kjo aspak nuk më shqetëson. Janë toplojtarë, por e rëndësishme është se janë futbollistë tanë dhe kjo nuk do të ndryshojë", ka thënë Thomas Tuchel, trajner i PSG-së.

Në fundjavë nis kampionati i ri në Formula, aplikohet shpërblim për xhiron më të shpejtë

Në Formulën 1 është gjetur një mënyrë për t'i ndezur edhe më shumë garat e Botërorit të këtij viti. Piloti që do ta shënojë xhiron më të shpejtë gjatë garave do të fitojë një pikë më shumë, por me kushtin që ai të jetë mes 10 pilotëve të parë në përfundim të garës. Kjo ide është zyrtarizuar tashmë edhe nga Federata Ndërkombëtare e Automobilizmit (FIA) dhe do të aplikohet që nga kjo fundjavë në Melbourne, kur do të zhvillohet edhe gara e hapjes së këtij sezoni, ajo për Çmimin e Madh të Australisë. Pika që do të jepet për pilotin me xhiron më të shpejtë vlen edhe për klasifikimin e konstruktorëve, që do të thotë se gjatë këtij sezoni do të jepen 21 pikë shtesë. Kjo nuk është hera e parë që aplikohet një rregull i tillë, pasi më herët është zbatuar edhe në Botërorin e Formulës 1 në periudhën 1950-1959.

C.nr.1771/16.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, si gjykatë Civile e shkallës së parë me gjyqtarin Lekë Prenaj duke vendosur në çështjen juridike të paditësës Fidane Toplica nga Vushtrria, me vendbanim në Gjermani, të cilën e përfaqëson av. Leonora Dervishaj Pacolli sipas autorizimit të bartur, kundër të paditurit Gëzim Geri, ish nga Fushë Kosova, tani me vendbanim të panjohur në Serbi, për zgjidhje të martesës, në seancë, me datë 24.10.2018, mori këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurit Gëzim Geri, ish nga Fushë Kosova, tani me adresë të panjohur, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, av.Arbër Osmanaj nga Prishtina.

Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha autorizimet në këtë çështje juridike për të ndërmarrë veprime juridike për mbrojtjen e interesave të të paditurit, deri në momentin kur i padituri të paraqitet personalisht në Gjykatë, të caktoj të autorizuarin e tij apo deri në momentin kur organi i kujdestarisë - Qendra për Punë Sociale në Prishtinë t'ia caktojë kujdestarin.

Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm i bartë paditësi.

Ky aktvendim do të publikohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate, në njërën nga gazetat ditore të Kosovës dhe do t'i dorëzohet përfaqësuesit të përkohshëm dhe Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paditësi kundër të paditurit ka ushtruar padi për zgjidhje të martesës.

Gjykata ka shqyrtuar propozimin e të autorizuarit të paditësit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për shkak se për të paditurin Gëzim Geri, sipas fletëkthesës së dt:24.08.2018 është konstatuar se i padituri nuk jeton në adresën, si në shkresat e lëndës. Po ashtu nga Ministria e Punëve të Brendshme – Agjencioni per regjistrim civil nuk janë gjetur të dhëna sa i përket adresës së tij.

Nisur nga kjo rrethanë Gjykata ka zbatuar dispozitën e nenit 79.1, 79.3 nën a, 79.4, dhe 81 të LPK-së, ashtu që të paditurit i'a ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm,
C.nr.1771/16, me datë 24.10.2018.

Këshillë Juridike:
Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.

Gjyqtari
Lekë Prenaj

C.nr.1771/16.

BASIC COURT IN PRISHTINA - General Department, as a first instance Civil Court, with the Judge Lekë Prenaj deciding on the legal matter of the plaintiff Fidane Toplica from Vushtrri, with residence in Germany, represented by attorney Leonora Dervishaj Pacolli according to the transferred authorization, against the accused Gëzim Geri, formerly from Fushe Kosova, currently resided in unknown location in Serbia, for dissolution of marriage, in the session held on 24.10.2018, rendered this:

R U L I N G

The accused Gëzim Geri, formerly from Fushe Kosova, currently resided in unknown address, has been assigned a temporary representative, attorney Arbër Osmanaj from Prishtina.

Temporary representative has all the authorizations on this legal matter to take legal actions for protection of interests of the accused, until the accused personally appears in front of the Court, appoints his authorized person or until the Custodian Authority - Centre for Social Welfare in Prishtina appoints his custody.

The expenses for the temporary representative will be covered by the plaintiff.

This ruling will be published on the Official Gazette of the Republic of Kosovo, in the notification board of this Court, in one of the daily newspapers of Kosovo and it will be submitted to the temporary representative and the Centre for Social Welfare in Prishtina.

R e a s o n i n g

The plaintiff against the accused has exercised plaint for dissolution of marriage.

The Court has reviewed the proposal of the authorized person of the plaintiff for appointment of the temporary representative because for the accused Gëzim Geri, according to the acknowledgement of receipt dated 24.08.2018 it is concluded that the accused does not live in the address, as per case file documents. Also there were no data found by the Ministry of Internal Affairs - Civil Registry Agency regarding his address.

Based on these circumstances, the Court applied provision of the Article 79.1, 79.3 item a, 79.4 and 81 of the LCP, so that the defendant is assigned the temporary representative from the Kosovo Bar Association.

From the above it was decided as in the enacting clause of this ruling.

BASIC COURT IN PRISHTINA, General Department,
C.nr.1771/16, on date 24.10.2018.

Legal remedy:
No appeal is allowed against this ruling.

Gjyqtari
Lekë Prenaj

I, the undersigned Dhurata Thaqi Fondaj, Certified Translator/Interpreter for English language, do hereby certify that the foregoing is an accurate translation of the original document from the Albanian language. In witness whereof, I have hereunto set my hand and affixed my seal on March 6th, 2019. T: +377 (0)44 222 981; Email: dhuratathf@gmail.com

C.br.1771/16

OSNOVNI SUD U PRIŠTINI – **Opšta Uprava**, kao prvostepeni Civilni Sud, sudija Lekë Prenaj, odlučujući o pravnom pitanju tužila Fidane Topanica iz Vučitrna, sa mestom boravka u Nemačkoj koju zastupa advokat Leonora Dervishaj Pacolli po ovlašćenju protiv tuženog Gëzim Geri bivši iz Kosovo Polja, sada sa nepoznatom mestom stanovanja u Srbiji, za razvod braka na sednici od 24.10.2018 godine donosi :

R E Š E N J E

Tuženi Gëzim Geri bivši iz Kosovo Polja, sada sa nepoznatom mestom stanovanja, odredjuje mu se privremeni zastupnik, advokat Arbër Osmanaj iz Prištine.

Privremeni zastupnik ima sva ovlašćenja u ovom pravnom pitanju da bi preduzeo pravne radnje za zaštitu interesa tuženog, do trenutka kada tuženi prijavi lično u Sudu, da odredi svog ovlašćenog ili do trenutka kada organ starateljstva – Centar za Socijalni rad u Prištini odredi mu staratelja.

Troškove za privremeno zastupanje snosi tuženi.

Ovo rešenje objavit će se u službenom glasniku Republike Kosova na oglasnoj tabli ovog suda, na jednoj od dnevne štampe Kosova i dostavit će se privremenom zastupniku i Centru za Socijalni Rad u Prištinu.

Obrazloženje

Tužioc protiv tuženika podneo je tužbu za razvod braka.

Sud je razmatrao predlog ovlašćenog od strane tuženika za odredjivanje privremenog zastupnika zbog toga što za tuženog Gezim Geri prema povratnici od 24.8.2018 godine utvrdjeno je da tuženik ne živi u adresi, kao u spisima predmeta. Takodje iz Ministarstva Unutrašnjih Poslova, Agencija za Civilnu Registraciju nisu pronadjeni podaci što se tiče njegove adrese.

Iz ovih okolnosti Sud je primenio odredbe člana 79.1, 79.3 pod a, 79.4 I 81 KZK-a, tako da tuženom odredjuje privremenog zastupnika iz redova Advokatske Komore Kosova.

Iz gore navedenog odlučeno je kao u dispozitivu ovog rešenja.

OSNOVNI SUD U PRIŠTINI – Opšta Uprava

C.br.1771/16 dana 24.10.2018

Pravni savet:

Protiv ovog rešenja nije dopuštena žalba.

S u d i j a,

Lekë Prenaj

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ "Pure Parfume" SH.P.K. shpallë të pavlefshme dokumentet e biznesit me nr. fis. 601626924 nr. biz.71276120 si dhe nr. e TVSH-së, 330322941.

▶ D.P.T "NUR" shpallë ta pavlefshme N.B. 70058634.

▶ Florim Bytyqi shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Veton Qenaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I-VIII SHF "Bajram Curri" Romajë.

▶ Lavdim Qenaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Bajram Curi" Romajë

▶ Dushko Jovanovic shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Ymerli Skenderaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Mic Sokoli" Lubiqevë.

▶ Bekim Gashi shpall te pavlefshme dëftesat SHF "Liria" Sapniq

▶ Armend Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

▶ Muso Kasi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I -VIII shf "25 Maji" Gornje Lubinje.

▶ "Taksi" B.I shpall te pavlefshme certifikatën e numrit fiskal: 600734132 Duhel Prizren.

▶ Urgjentisht kërkoj një garsoniere me qera ne Fushë Kosovë për 1 person. Banesën e kërkoj për afatgjatë, ndërsa pagesën e kryej menjëherë për një vit. Për informata mund të më kontaktoni në këtë numër të telefonit: Tel 044 741 155

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv.
Tel. 044-413-197, wiber: 045-198-095.

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës:	"Brigada 125"
Komuna:	Prizren
Data:	14.03.2019
Emri i kontratës:	Blerja e mjeteve te teknologjisë
Numri i kontratës:	ESIP/SDG/83 – G/1.2

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës **"Brigada 125",**Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

Përshkrimi i shërbimeve te nevojshme:

- Aparat fotokopjues
- Dy Projektor

Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 1 kontrate për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

